



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 107/3 Prot.

Tiranë, më 07.02.2023

V E N D I M

Nr. 25, Datë 07.02.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 14 Regj., datë 18.01.2023, e Shoqatës “Ilinden¹”, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “etnisë²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Shoqata “Ilinden”, përfaqësuar nga Kryetari i saj, N. Gj, në ankesën e sjellë pranë Komisionerit shprehet se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në vijim referuar si KQZ) ka miratuar një program të veçantë edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi të zgjedhësve-pjesëtarë të pakicave kombëtare për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

Në ankesë citohet ndër të tjera, se, me datë 14 Janar 2023, në faqen e facebook-ut të KQZ është bërë njoftimi për programin sipërcituar dhe se në posterin në gjuhën maqedonase, komuniteti maqedonas figuron si “Pakica Kombëtare e Maqedonisë së Veriut”.

¹ Regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 2473, datë 06.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe bazuar në ndryshimet specifike të pasqyruara ne Vendimin nr.2473/1, datë 06.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

² Shoqata “Ilinden” përfaqëson interesat dhe të drejtat e pakicës kombëtare maqedonase në Shqipëri.

Shoqata e konsideron këtë emërtesë dhe publikim si fyerje të rëndë për pakicën kombëtare maqedonase në Shqipëri dhe kërkon që të korrigjohet postimi dhe posterit në fjalë, si dhe nga ana e KQZ, në të gjitha publikimet, fletëpalosjet dhe posterat për komunitetin maqedonas të përdoret termi “Pakicë Kombëtare Maqedonase” ashtu sikurse njihet zyrtarisht në Shqipëri.

Shoqata ka kërkuar njëherësh që, nga ana e KQZ fushata e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, të cilët janë pjesëtarë të pakicave kombëtare maqedonase, për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, në zonat ku jeton pakica kombëtare maqedonase të bëhet në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të marrë masa të ndryshohet posterit, të tërhiqet artikulli nga rrjetet sociale dhe materialet zyrtare.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Shoqata “Ilinden”, është një organizatë jofitimpurëse, joqeveritare, e regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 2473, datë 06.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave, të drejtave e identitetit etnik, kulturor dhe fetar të minoritetit kombëtar Maqedonas në Shqipëri.

Bazuar në ankesën e paraqitur, Shoqata “Ilinden” pretendon diskriminimin e pakicës kombëtare maqedonase në Shqipëri, nga ana e KQZ, përmes përdorimit të termit “Pakica Kombëtare e Maqedonisë së Veriut”, në publikimet e bëra prej tyre në kuadër të fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve-pjesëtarë të pakicave kombëtare për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar pasi KQZ, në të gjitha publikimet, fletëpalosjet dhe posterat për komunitetin maqedonas, ka përdorur termin “Pakica Kombëtare e Maqedonisë së Veriut”, në vend të termit “Pakicë Kombëtare Maqedonase” ashtu sikurse njihet zyrtarisht në Shqipëri.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një subjekt, i cili nuk pretendon diskriminim në emrin e vet,

pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që ky subjekt të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtës i interesave kolektive, të cilat mund të çënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ai kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, subjekti ankues, Shoqata “Ilinden”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllim mbrojtjen e interesave, të drejtave e identitetit etnik, kulturor dhe fetar të Pakicës Kombëtare Maqedonase në Shqipëri.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Shoqatës dhe çështjes që ky subjekt/kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Shoqata “Ilinden”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të shtetasve që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase në Shqipëri.

Shkaku i pretenduar nga subjekti ankues, *etnia*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen

ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 107/1 prot., datë 23.01.2023, nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion KQZ-së, si palë kundër së cilës është paraqitur ankesa.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, KQZ, me anë të shkresës nr. 372/1 prot., datë 27.01.2023, ndër të tjera, ka informuar Komisionerin, si më poshtë vijon:

“...Pas vënies në dijeni të këtij pretendimi nga ana e Shoqatës, KQZ, konstatoi gabimin teknik të postuar në rrjetin social “Facebook” dhe gjithçka është rregulluar, të gjitha publikimet që lidhen me procesin e zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023, komuniteti maqedonas do të jetë me shënimin “Pakica Kombëtare Maqedonase”. Nëpërmjet shkresës me nr. 182/1 prot., datë 25.01.2023, KQZ, informoi Ambasadorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, se nëpërmjet programeve, zgjedhësit e pakicave kombëtare do të informohen në gjuhën e tyre, për të gjitha proceset zgjedhore në vend.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, në Vendimin nr. 222, datë 07.12.2022 “Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është përdorur termi korrekt “Pakica Kombëtare Maqedonase”. Ju bëjmë me dije se, pakica kombëtare që jeton në bashkitë Pustec, Bulqizë, Librazhd, Kukës dhe Devoll, do të jetë e informuar për procesin zgjedhor të datës 14 Maj 2023, sipas programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve për pakicat kombëtare që jetojnë në vendin tonë, të KQZ”.

KZQ ka bashkëlidhur shkresës sipërcituar dhe dokumentacionin përkatës.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Shoqatës “Ilinden”, i janë dërguar nëpërmjet e-mailit³, përgjigjja shkresore dhe dokumentacioni bashkëlidhur, nga ana e KQZ-së.

Pasi është njohur me qëndrimin e provat e sjella nga KQZ, përfaqësuesi e Shoqatës “Ilinden”, z. Gjurgjaj, nëpërmjet email-it të dërguar po me datë 30.01.2023, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e shpejtë dhe masat e ndërmarra nga ana e KQZ-së, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për konsiderimin dhe zgjidhjen e problematikës së përdorimit të gabuar të termit referuar pakicës kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga Shoqata “Ilinden”, e cila është tërhequr nga ankesa, pasi falë ndërhyrjes në KMD-së, është arritur qëllimi për të cilin kjo Shoqatë kishte depozituar këtë ankesë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

³ Dërguar nga inspektori i çështjes nëpërmjet e-mailit të datës 30.01.2023.

“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 14 Regj., datë 18.01.2023, të Shoqatës “ILINDEN”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA